

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
GRAY2018 SHPK**

**Neni 1
Emërtimi i Shoqërisë**

Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin Gray2018 SHPK, (këtej e tutje referuar si “Shoqëria”).

**Neni 2
Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr Jordan Misja pallati Reno shpk. Shkalla 4 Kati 7 ap 14, Tiranë, Shqipëri.,

**Neni 3
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është e pakufizuar.

**Neni 4
Objekti i veprimtarisë.**

Objekti i Shoqërisë është:

1. Zyre real estate, prona shitje blerje etj sherbime te tjera
2. çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i domosdoshëm për realizimin e qëllimeve të Shoqërisë dhe nuk është i ndaluar nga legjislacioni në fuqi.

Shoqëria do të fillojë aktivitetin e saj ekonomike pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit sipas legjislacionit në fuqi.

**Neni 5
Kapitali**

Kapitali i nënshkruar dhe tërësisht i paguar i Shoqërisë është 100 lek. (njëqinde) lek, i cili përbëhet nga 1 (nje) kuote me vlerë nominale prej 100 (njëqind) lekë . Kapitali është nënshkruar dhe paguar si më poshtë:

5.1.1 Stefania Harizi, zotëron 1 (nje) kuote të cila përbënë 100% (njëqind perqind) të kapitalit të Shoqërisë.

**Neni 6
Përgjegjësia e ortakëve**

Ortakët kanë përgjegjësi të kufizuar, sipas legjislacionit në fuqi.

**Neni 7
Organet e Shoqërisë**

Organet e Shoqërisë janë:

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakëve/Ortaku i Vetëm është Zj. Stefania Harizi administratori, ushtron funksione administrimi të veprimtarisë së shoqërisë. Emërohet administrator i shoqërisë Zonja Stefania Harizi


Neni 8
Eksperti/ët kontabël i/të autorizuar

Auditimi i Shoqërisë kryhet nga një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar të emëruar nga Asambleja e ortakëve. Emërohet si ekspert kontabël iu shoqërisë **zoti.**

Neni 9
Dispozitë Përfundimtare

Për ç'farë nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi, do të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi për Shoqëritë Tregtare.

ASAMBLEJA E ORTAKVE/ORTAKU I VETEM
SHOQËRIA Gray2018 SHPK



ZJ. STEFANIA HARIZI